



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____._____.2024

PËR
DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012 “PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Në Nenin 40 “Statusi i pullave fiskale”, pika 1, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Pulla fiskale është dokument me vlerë dhe është monopol shtetëror. Këshilli i Ministrave përcakton personin e autorizuar për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale, si dhe elementët e sigurisë së tyre.”.

Neni 2

Në nenin 41 “Aplikimi i pullave fiskale” në pikën 8, gërma d), hiqet fjala “me koncesionarin”.

Neni 3

Në nenin 42 “Pagesa dhe tërheqja e pullave fiskale” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Çmimi për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga personi i autorizuar përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve, sipas ligjit, u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale i paguajnë personit të autorizuar çmimin e pullave të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Në pikën 3, fjala “koncesionarin”, zëvendësohet me togëfjalëshin “personin e autorizuar për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale. ”.

Neni 4

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë, me përjashtim të neneve 2 dhe 3, efektet e të cilave fillojnë nga 1 Janari 2025.

KRYETARI

Lindita Nikolla

